



BULETINI M U J O R I

KORRIK 2026



► ***Miratohet Vendimi për krijimin e Institutit Kombëtar të Tumoreve dhe zgjerohet aksesimi në Check Up falas***

Për herë të parë, Shqipëria do të ketë një Institut Kombëtar të Tumoreve, të organizuar sipas modeleve më të mira evropiane, me kërkim shkencor dhe akses në barna inovative. Njëkohësisht, ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala bëri me dije se do të zgjerohet programi falas i Check-Up-it për çdo qytetar mbi 35 vjeç, pa kufizim të sipërm moshe, duke përfshirë për herë të parë edhe qytetarët mbi 70 vjeç. Po ashtu, shërbimet e Check-Up-it dhe dializës do të kalojnë nën administrimin e shtetit, duke garantuar vazhdimësi, cilësi dhe akses më të mirë për qytetarët.



► **13 autoambulanca të reja i shtohen Urgjencës Kombëtare, ministrja Sala: Reagim më i shpejtë dhe mbulim më i mirë në të gjithë vendin**

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore është pajisur me 13 autoambulanca të reja, të cilat do të ofrojnë shërbim përmes aparaturave dhe sistemeve jetëshpëtuese sipas standardeve më të avancuara evropiane. Ky investim forcon kapacitetet e flotës së urgjencës, përmirëson kohën e reagimit, rrit sigurinë e pacientëve gjatë transportit dhe zgjeron mbulimin e territorit me mjete moderne të emergjencës, veçanërisht në kulmin e sezonit turistik.



► *Dyfishohen pagesat për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe njihen kontributet për 14 mijë ndihmës personale*

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, gjatë një bashkëbisedimi me prindër të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Qendrën e Shërbimeve Komunitare të Integruara në Prush, prezantoi masat e reja të miratuara nga Qeveria Shqiptare në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre duke theksuar se për herë të parë garantohet mbështetje për të gjithë ndihmësit personalë, pa dallim diagnoze apo moshe, duke siguruar trajtim të barabartë, më shumë siguri sociale dhe mbështetje për familjet. Përmes Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026, është dyfishuar pagesa mujore për 11 mijë fëmijë me aftësi të kufizuara dhe do të njihen kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për 14 mijë ndihmës personalë.



► **Reformat e fundit në shëndetësi ulin ndjeshëm kohën e pritjes për CT, MRI dhe Koronarografi**

Reformat e ndërmarra në sistemin shëndetësor kanë sjellë përmirësime të prekshme në aksesin e qytetarëve ndaj shërbimeve diagnostikuese dhe procedurave të specializuara, duke reduktuar ndjeshëm kohën e pritjes. Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2026, koha mesatare e pritjes për ekzaminimin CT është ulur në 7.8 ditë, nga 24.3 ditë në vitin 2025. Për MRI, koha e pritjes është reduktuar në 72.3 ditë, nga 80.3 ditë një vit më parë, ndërsa për koronarografinë është përgjysmuar, duke zbritur nga 111 ditë në 46 ditë. Këto rezultate pasqyrojnë efektet konkrete të reformave për rritjen e aksesit, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor në kohë për pacientët.



► *Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Institutit Kombëtar të Tumoreve në Milano*

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Instituti Kombëtar i Tumoreve në Milano (Istituto Nazionale dei Tumori – INT) nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit, duke shënuar një hap të rëndësishëm në transformimin e shërbimit onkologjik shqiptar. Ky partneritet me një nga qendrat më të njohura europiane të ekselencës në fushën e onkologjisë synon forcimin e kapaciteteve klinike, shkencore dhe organizative, si dhe afrimin e praktikave të kujdesit për pacientët shqiptarë me standardet më të avancuara europiane.



► **Kryeministri Rama dhe ministrja Sala bashkëbisedim me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara për paketën e mbështetjes financiare**

Kryeministri Rama dhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof. Evis Sala vizituan Qendrën Sociale "Jonathan", ku bashkëbiseduan me nëna dhe stafin mbështetës të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, mbi dyfishimin e mbështetjes ekonomike për këtë kategori, si dhe për garancitë e reja shëndetësore e shoqërore për kujdestarët e tyre. Ndërkohë që Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi Ndryshe 2026–2030, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, parashikon, krahas dyfishimit të pagesës, edhe më shumë shërbime në komunitet, akses më të lehtë në arsim, punësim dhe rehabilitim, si dhe mbështetje më të madhe për jetesë të pavarur.



► Lançohet Linja e Këshillimit për të Moshuarit, ministrja Sala: Drejt krijimit të Shërbimit të Geriatriisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale po ndërmer politika të reja për zgjerimin e aksesit në shërbimet shëndetësore dhe sociale, me fokus mbështetjen e të moshuarve. Për herë të parë, lançohet Linja e Këshillimit për të Moshuarit, një shërbim i dedikuar për informim, orientim dhe mbështetje në aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore, sociale dhe shërbimeve të tjera publike. Në takimin me qytetarë të moshës së tretë në Qendrën Komunitare Ditore në Pogradec, ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, prof.Evis Sala bëri me dije se po punohet për ngritjen e Shërbimit të Geriatriisë për të moshuarit në QSUT, e për pas me shtrirje edhe në rajonë të tjera në vend.



► *Shqipëria miraton Planin Kombëtar për Eliminimin e Hepatiteve Virale*

Për herë të parë, Shqipëria miraton Planin Kombëtar për Eliminimin e Hepatiteve Virale, duke iu bashkuar objektivit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe vendeve evropiane për eliminimin e hepatiteve B dhe C si kërcënim për shëndetin publik deri në vitin 2030. Ky Plan shënon fillimin e një angazhimi të ri për forcimin e parandalimit dhe survejancës, zgjerimin e testimit dhe diagnostikimit të hershëm, përmirësimin progresiv të aksesit në trajtim dhe afrimin e shërbimeve më pranë qytetarëve, duke patur si objektiv më pak infeksione të reja, më shumë diagnoza dhe trajtime në kohë, më pak cirrozë e kancer të mëlçisë dhe më shumë jetë të mbrojtura.



► *Ministrja Sala nga Tale: Tarifat vlejné vetëm për turistët e huaj, të ardhurat do të përdoren nga vetë QSHV*

Gjatë inspektimit në Qendrën Shëndetësore Verore në Tale, Lezhë, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Prof. Evis Sala, theksoi se tarifat për shërbime të caktuara shëndetësore janë vetëm për turistët e huaj dhe nuk prekin në asnjë rast qytetarët shqiptarë, të cilët vijojnë të marrin shërbim shëndetësor falas, siç parashikohet nga sistemi publik. Ajo bëri me dije se të ardhurat e përfituara nga tarifimi do të përdoren nga vetë qendrat shëndetësore për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe plotësimin e nevojave më imediate.





BULETINI M U J O R I

KORRIK 2026

► Shqipëria në "Genuine Cup 2026" me të rinjtë me aftësi të kufizuara, një hap i rëndësishëm drejt gjithëpërfshirjes

Për herë të parë, Kombëtarja Shqiptare e Futbollit e personave me aftësi të kufizuara d përfaqësoi Shqipërinë në "Genuine Cup 2026", një aktivitet ndërkombëtar sportiv i cili u zhvillua në Houston, Texas, SHBA, nga 26 korriku deri më 2 gusht. Pjesëmarrja e 12 futbollistëve të rinj me aftësi të kufizuara intelektuale në këtë kompeticion është një dëshmi e angazhimit për përfshirjen sociale, fuqizimin e personave me aftësi të kufizuara dhe garantimin e mundësive të barabarta përmes sportit. Në bashkëbisedim me futbollistët dhe prindërit e tyre, ministrja Sala vlerësoi këtë moment historik për sportin gjithëpërfshirës në Shqipëri, duke theksuar se Qeveria Shqiptare po ndërton politika që shkojnë përtej mbështetjes ekonomike, për të krijuar mundësi reale për pjesëmarrje në arsim, punësim, kulturë dhe sport.

